

**SHOQERIA TREGETARE "KOMBINATI MISHIT" Sh.p.k**  
**Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

**V E N D I M**  
**Nr. 4 datë 15.12.2021**

Sot, më datë 15 Dhjetor 2021, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë tregtare "KOMBINATI MISHIT" Sh.p.k, shoqëri e regjistruar si person juridik pranë QKB-së, e indentifikuar me NUIS-in J72216002H, bazuar në ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në statutin e shoqërisë, pasi mori në shqyrtim projektin e administratorit dhe raportin e ekspertit kontabël të regjistruar për zmadhimin e kapitalit të regjistruar nëpërmjet fitimeve të pashpërndara që rezultojnë në pasqyrat financiare të vitit 2020, në përfundim,


**VENDOSI:**


1. Miratimin e projektit të zmadhimit të kapitalit të regjistruar të shoqërisë nëpërmjet fitimeve të pashpërndara dhe të raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar (Audituesit Ligjor), i caktuar për këtë qëllim me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr.3, datë 10.12.2021,
2. Zmadhimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë nga fitimet e pashpërndara në shumën 20,000,000 lekë. Shtesa e kapitalit do të përfitohet nga ortakët ekzistues në përpjestim me kuotat që zotërojnë:
  - Z. Grigor Lengo, zotërues i kuotës 76 %, do të përfitojë 15,200,000 lekë të shtesës së kapitalit.
  - Z. Spiro Lengo, zotërues i kuotës 12 %, do të përfitojë 2,400,000 lekë të shtesës së kapitalit.
  - Znj. Jona Lengo, zotërues i kuotës 12 %, do të përfitojë 2,400,000 lekë të shtesës së kapitalit.


Pas këtij zmadhimi kapitali i regjistruar i shoqërisë behet 412,414,000 lekë nga 392,414,000 lekë që ishte para zmadhimit.

3. Ndryshimin e nenit 7 të statutit të shoqërisë "Vlera e kapitalit të regjistruar", që tani lexohet si më poshtë:  
"Kapitali themeltar i regjistruar i shoqërisë është 412,414,000 lekë, i ndarë në 3 (tre) kuota kapitali dhe zotërohet nga ortakët:
  - Z. Grigor Lengo, është zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 313,434,640 lekë, që përbën 76 % të kapitalit të regjistruar.
  - Z. Spiro Lengo, është zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 49,489,680 lekë, që përbën 12 % të kapitalit të regjistruar.
  - Znj. Jona Lengo, është zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 49,489,680 lekë, që përbën 12 % të kapitalit të regjistruar".
4. Të ngarkojë administratorin e shoqërisë, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar prej tij, për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE TE SHOQERISE "KOMBINATI MISHIT" Sh.p.k**

Spiro Lengo  


Jona Lengo  


Grigor Lengo  




**SHOQERIA TREGETARE "KOMBINATI MISHIT" Sh.p.k**  
**Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

**V E N D I M**

**Nr. 3, datë 10.12.2021**

Sot, më datë 10 Dhjetor 2021, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë tregtare "KOMBINATI MISHIT" sh.p.k, shoqëri e regjistruar si person juridik pranë QKB-së, e indentifikuar me NUIS-in J72216002H, e bazuar në ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" dhe në statutin e shoqërisë, pasi mori në shqyrtim projektin e zmadhimit të kapitalit nga fitimet e pashpërndara, të paraqitura nga administratori i shoqërisë, në përfundim,

**VENDOSI:**


1. Të caktojë shoqërinë audituese "AS-Audit Services" sh.p.k, me ortak kryesor të angazhimit audituesin ligjor z.Afrim Suli, mbajtes i liçencës profesionale nr.4, date 11.01.2000 për të vlerësuar dhe konfirmuar mundësinë e zmadhimit të kapitalit të regjistruar nga fitimet dhe rezervat, të paraqitur në projektin e zmadhimit nga administratori i shoqërisë.  
Termat e angazhimitit për kryerjen e misionit dhe honoraret e shërbimit do të jenë sipas marrëveshjes së lidhur me administratorin e shoqërisë.
2. Në mbledhjen e ardhëshme, së bashku me projektin e zmadhimit, të paraqitet dhe raporti konfirmues i Ekspertit Kontabel të Regjistruar (Audituesi Ligjor) për zmadhimit të kapitalit të regjistruar të shoqërisë nga fitimet e pashpërndara.
3. Të ngarkojë administratorin e shoqërisë, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar prej tij, për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE TE SHOQERISE "KOMBINATI MISHIT" Sh.p.k**

**Spiro Lengo**

*Spiro Lengo*  


**Jona Lengo**

*Jona Lengo*  


**Grigor Lengo**

*Grigor Lengo*  




**SHOQERIA TREGETARE "KOMBINATI MISHIT" Sh.p.k**  
**Administratori**

**Tiranë, me 15.12.2021**

**Deklarate e administratorit për regjistrimin dhe publikimin e zmadhimit të kapitalit me  
aktivet e shoqërisë**

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "KOMBINATI MISHIT" Sh.p.k, me vendimin nr.4 datë 15.12.2021, ka vendosur për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me aktivet e shoqërisë, rezervat dhe fitimet e pashperndara, për vlerën 20.000.000 lekë, dhe gjithashtu ka autorizuar ndjekjen e procedurave për regjistrimin e zmadhimit në QKR.

Bazuar dhe në plotësim të kërkesave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", specifikisht të nenit 178 të tij, me cilesinë e administratorit të shoqërisë vërtetoj se gjendja e aktiveve të shoqërisë të "KOMBINATI MISHIT" sh.p.k është e tillë që, nëse vendimi për zmadhim do të ishte marrë në datën e aplikimit për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, zmadhimi është plotësisht i mundur.

**ADMINISTRATORI I SHOQERISE "KOMBINATI MISHIT" Sh.p.k**

**Grigor Lengo**

